Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 11.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, debllokimi i kanalizimit atmosferik (heqja e borës, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – e ndarë në VI LOT-e." me nr. të prokurimit 616-26-9518-2-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "2A Group shpk" të datës 11.11.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, debllokimi i kanalizimit atmosferik (heqja e borës, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – e ndarë në VI LOT-e." me nr. të prokurimit 616-26-9518-2-1-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "AGE Group shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 11.11.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Mirëmbajtja dimërore e rrugëve dhe trotuareve, debllokimi i kanalizimit atmosferik (heqja e borës, fshirja e mbeturinave dhe larja sipas kushteve) – e ndarë në VI LOT-e." me nr. të prokurimit 616-26-9518-2-1-1.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1-Vendosja e specifikimeve teknike kufizuese, të paqarta dhe joproporcionale me natyrën e shërbimeve

Autoriteti Kontraktues, me rastin e hartimit të Dosjes së Tenderit, konkretisht Aneksit 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, ka përcaktuar kërkesa teknike të cilat në disa pozicione tejkalojnë nevojat e demonstruara për realizimin e shërbimeve dhe krijojnë kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Sipas nenit 7 të LPP-së, Autoriteti Kontraktues është i obliguar t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese, duke shmangur kërkesat që reduktojnë apo eliminojnë konkurrencën.

Po ashtu, sipas nenit 28 të LPP-së dhe nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, specifikimet teknike duhet të hartohen në mënyrë të qartë, të saktë dhe jodiskriminuese, duke mos vendosur kufizime të paarsyeshme.

Nga analiza e paramasave dhe e specifikimeve teknike rezulton se objekti i kontratës përfshin kryesisht largimin e borës dhe akullit, shpërndarjen e kripës dhe rërës, fshirjen dhe larjen e rrugëve, pastrimin e ujëmbledhësve dhe aktivitete të tjera të mirëmbajtjes.

Për kryerjen e këtyre aktiviteteve është i domosdoshëm angazhimi i mekanizimit adekuat. Megjithatë, nuk rezulton se çdo kufizim i peshës, presionit, kapacitetit dhe konfigurimit të kërkuar në Aneksin 8 është i domosdoshëm për përmbushjen e kontratës.

Përcaktimi i parametrave të tillë krijon rrezik që nga konkurrenca të përjashtohen operatorë ekonomikë që disponojnë pajisje plotësisht funksionale dhe të përshtatshme për realizimin e shërbimeve.

Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues të rishikojë specifikimet teknike dhe t'i përcaktojë ato sipas kapaciteteve minimale funksionale dhe performancës së kërkuar, duke lejuar pajisje ekuivalente.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2-Vendosja e kufirit maksimalë të peshës së pajisjeve

Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të Aneksit 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, ka vendosur kufij maksimalë të peshës për një numër të konsiderueshëm pajisjesh, ndërsa brenda të njëjtave LOT-e ka paraparë përdorimin e makinerive me peshë apo kapacitet dukshëm më të lartë.

Konkretisht, në LOT I, II, III dhe V, për fshesat e rrugëve, kamionetat dhe pajisjet e tjera, janë përcaktuar kufij maksimalë prej 2, 3, 6, 7, 10 dhe 12 ton, ndërkohë që brenda të njëjtave LOT-e parashihet përdorimi i kamionëve, cisternave dhe makinerive me tonazh apo kapacitet më të madh.

Për shembull, në LOT I, pozicioni 5, kërkohet fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale maksimum 2 ton, ndërsa në pozicionin 11 kërkohet kamion cisternë për larjen e rrugëve me kapacitet mbi 10,000 litra ujë. Vetëm kjo sasi uji përfaqëson masë mbi 10 ton, pa përfshirë peshën e vetë kamionit.

Nëse infrastruktura rrugore mundëson operimin e një cisterne të tillë, lind pyetja se mbi çfarë baze teknike kufizohet pesha maksimale e fshesës në 2 ton, duke përjashtuar një fshesë me peshë më të madhe, e cila mund të jetë plotësisht e përshtatshme dhe më produktive për pastrimin e të njëjtave rrugë.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kundërthënie të ngjashme evidentohen edhe në LOT-et e tjera:

- ***LOT II: Kërkohen fshesa me peshë maksimale 4, 7 dhe 10 ton, ndërsa parashihen edhe kamionë për pastrimin e borës me peshë bartëse minimale 7.5 ton dhe kamionë kiper me peshë bartëse mbi 8 ton.***
- ***LOT III: Kërkohen fshesa maksimum 3, 6 dhe 12 ton, ndërsa për larjen e rrugëve kërkohet cisternë me kapacitet minimum 16,000 litra.***
- ***LOT IV: Kërkohet fshesë maksimum 6 ton, ndërsa ngarkuesi duhet të ketë minimum 20 ton dhe ekskavatori minimum 19 ton.***
- ***LOT V: Kërkohet fshesë maksimum 2 ton dhe kamion për mbeturina maksimum 5.5 ton, ndërsa kamionët për borë duhet të kenë minimum 8 ton dhe ngarkuesi ose ekskavatori minimum 15 ton.***
- ***LOT VI: Kërkohet automjet për pastrimin e borës maksimum 3.5 ton, ndërsa në të njëjtin LOT kërkohen ngarkues minimum 20 ton dhe ekskavator minimum 19 ton.***

Nëse në të njëjtin segment rrugor mund të operojë një cisternë apo makineri me peshë 19–20 ton, atëherë kufizimi i një fshese në maksimum 2 apo 3 ton nuk mund të mbështetet vetëm në pretendimin e përgjithshëm se infrastruktura nuk lejon makineri më të rënda. Një kufizim i tillë duhet të ketë arsyetim konkret, të matshëm dhe objektivisht të verifikueshëm.

Konsiderojmë se kjo mënyrë e hartimit të kritereve cenon qëllimin e shfrytëzimit efikas dhe ekonomik të fondeve publike sipas neneve 1 dhe 6 të LPP-së, parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit sipas nenit 7 të LPP-së, si dhe kërkesat për specifikime teknike jodiskriminuese sipas nenit 28 të LPP-së dhe nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Kufizimet e tilla krijojnë kushte favorizuese për operatorët që disponojnë makineri me karakteristika të caktuara, në dëm të operatorëve të tjerë që kanë kapacitete funksionalisht të barasvlershme ose më të larta.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që ta aprovojë si të bazuar këtë pretendim dhe të largojë nga Aneksi 8 kufijtë maksimalë të peshës së pajisjeve për të gjashtë LOT-et, duke lejuar makineri me peshë më të madhe, për sa kohë që ato janë të përshtatshme për realizimin e shërbimeve.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3-Mospërputhja ndërmjet Aneksit 1 dhe Specifikimet Teknike të Detyrueshme dhe Aneksit 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, lidhur me përcaktimin e presionit të pajisjeve për larjen e rrugëve

Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të Dosjes së Tenderit, konkretisht në Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme, pika 3.2 "Larja e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave të tjera publike", ka përcaktuar shprehimisht:

"Presioni i ujit, të cilin e mundëson kamioni për larje të rrugëve, duhet të jetë mbi 50 bar."

Me këtë kërkesë, AK ka përcaktuar standardin teknik të detyrueshëm për presionin e ujit që duhet të mundësojnë kamionët për realizimin e shërbimit të larjes së rrugëve.

Mirëpo, në kundërshtim me këtë përcaktim, në Aneksin 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, AK ka vendosur kërkesa të ndryshme për presionin e pajisjeve që shërbejnë për të njëjtin aktivitet, përkatësisht larjen e rrugëve.

Konkretisht:

- ***LOT I, pozicioni 9:*** *Kamionetë speciale për larjen e rrugëve, me presion minimum 120 bar.*

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

- ***LOT I, pozicionet 10 dhe 11:*** *Kamionë cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 50 bar.*
- ***LOT II, pozicioni 6:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 15 bar.*
- ***LOT II, pozicioni 7:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 350 bar.*
- ***LOT III, pozicioni 7:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 120 bar.*
- ***LOT III, pozicioni 9:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 5 bar.*
- ***LOT III, pozicioni 10:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 15 bar.*
- ***LOT V, pozicioni 6:*** *Cisternë për larjen e rrugëve, me presion minimum 15 bar.*

Nga përmbajtja e këtyre kërkesave rezulton se AK, në njërën anë, në Aneksin 1 ka përcaktuar pragun minimum 50 bar si kërkesë të detyrueshme për larjen e rrugëve, ndërsa në anën tjetër, në Aneksin 8, për të njëjtin lloj shërbimi ka vendosur pragje tjera minimale prej 5, 15, 50, 120 dhe 350 bar.

Konsiderojmë se një mënyrë e tillë e hartimit të specifikimeve teknike krijon mospërputhje dhe paqartësi ndërmjet kërkesave të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave.

Nëse, sipas Aneksit 1, presioni mbi 50 bar konsiderohet i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për realizimin e larjes së rrugëve, atëherë nuk është e qartë mbi çfarë baze teknike AK kërkon në LOT II, pozicioni 7, presion minimum 350 bar, apo në pozicione të tjera minimum 120 bar.

Njëkohësisht, nëse presioni mbi 50 bar është kërkesë e detyrueshme sipas Aneksit 1, atëherë mbetet e paqartë se si AK ka përcaktuar në LOT II dhe LOT III pajisje për larjen e rrugëve me presione minimale prej vetëm 5 apo 15 bar.

Këto dallime dëshmojnë mungesë harmonizimi ndërmjet kërkesave teknike të dokumentacionit të tenderit.

Si shembull, një operator ekonomik që disponon cisternë për larjen e rrugëve me presion 100 bar do të përmbushte kërkesën e përcaktuar në Aneksin 1, pika 3.2, mirëpo nuk do të përmbushte kërkesën e Aneksit 8 në LOT II, pozicioni 7, ku kërkohet minimum 350 bar.

Në këtë mënyrë, një pajisje që plotëson standardin teknik të detyrueshëm të përcaktuar nga vetë AK në Aneksin 1 do të mund të konsiderohej e papërshtatshme në bazë të një kriteri tjetër, më kufizues, të përcaktuar në Aneksin 8.

Konsiderojmë se AK duhet të hartojë specifikimet teknike në mënyrë të qartë, të harmonizuar dhe të kuptueshme, duke siguruar që kërkesat për të njëjtin shërbim të mos jenë të paqarta apo të pajustifikuara teknikisht.

Konsiderojmë se kjo mënyrë e hartimit të kërkesave teknike bie ndesh me parimet e përcaktuara në nenin 7 të LPP-së, lidhur me trajtimin e barabartë dhe mosdiskriminimin e operatorëve ekonomikë, si dhe me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, lidhur me përcaktimin e specifikimeve teknike të qarta, proporcionale dhe jodiskriminuese.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të largojë nga Aneksi 8 kufizimet e ndryshme të presionit të ujit për pajisjet e larjes së rrugëve dhe t'i harmonizojë ato me kërkesën e përcaktuar në Aneksin 1, pika 3.2, sipas së cilës presioni i ujit që mundëson kamioni për larjen e rrugëve duhet të jetë mbi 50 bar.

Gjithashtu, kërkojmë që specifikimet teknike të përcaktohen mbi bazën e funksionalitetit dhe efikasitetit të pajisjeve, duke pranuar të gjitha pajisjet që përmbushin kërkesën e detyrueshme të Aneksit 1 dhe janë të përshtatshme për realizimin e shërbimit.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 4-Hartimi i kërkesave teknike të paqarta dhe kundërthënëse në Aneksin 8, në kundërshtim me nenet 7, 27 dhe 28 të LPP-së

Autoriteti Kontraktues, në Aneksin 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, ka përcaktuar kërkesa teknike të paqarta, me njësi matëse të pasakta, formulime kundërthënëse dhe parametra të papërcaktuar, të cilët ndikojnë drejtpërdrejt në përgatitjen dhe vlerësimin e ofertave.

Konkretisht, evidentohen këto paqartësi:

LOT I:

- ***Poz. 7, 9, 10 dhe 11:*** *Kapaciteti i rezervuarëve në litra kërkohet të dëshmohet përmes peshës bartëse, ndonëse bëhet fjalë për dy karakteristika të ndryshme teknike.*
- ***Poz. 8:*** *Formulimi "mbi 12,00 litra" është numerikisht i paqartë dhe nuk përcakton saktë kapacitetin total të cisternës.*

LOT II:

- ***Poz. 1:*** *"Pesha mbi 300 L" – përdorim i njësisë së vëllimit për peshën.*
- ***Poz. 5:*** *"Minimum 3000 litra me peshë totale" – nuk përcaktohet qartë parametri që duhet dëshmuar.*
- ***Poz. 6 dhe 7:*** *Kërkohet sqarimi i dallimit ndërmjet kapacitetit maksimal dhe minimal 9,000 litra dhe mënyrës së dëshmimit të tyre.*

LOT III:

- ***Poz. 1:*** *"Pesha mbi 300 L" – njësi matëse e pasaktë.*
- ***Poz. 4: "Minimum maksimum 12 ton" – kundërthënie e drejtpërdrejtë e kriterit.***
- ***Poz. 7 dhe 8: Paqartësi lidhur me peshën totale, peshën bartëse dhe kufijtë e tyre.***
- ***Poz. 12: Nuk përcaktohet nëse maksimumi 1 ton i referohet kapacitetit ngritës të kranit apo peshës bartëse të kamionit.***

LOT IV:

- ***Poz. 9: "Minimum 6000 litra me peshë totale" – paqartësi në dëshmimin e kapacitetit.***

LOT V:

- ***Poz. 1:*** *"Pesha minimum 300 L" – njësi matëse e gabuar.*
- ***Poz. 5 dhe 6:*** *Nuk përcaktohet qartë mënyra e dëshmimit të vëllimit të rezervuarëve në raport me peshën totale apo bartëse.*

LOT VI:

- ***Poz. 1:*** *"Pesha mbi 300 L" – njësi matëse e gabuar.*
- ***Poz. 4:*** *"Vëllim mbi 3000 litra me peshë totale" – paqartësi mbi parametrin që duhet dëshmuar.*

Këto paqartësi nuk përbëjnë thjesht gabime formale, por mangësi në përcaktimin e kritereve të detyrueshme të kualifikimit, mospërmbushja e të cilave mund të rezultojë me eliminimin e operatorëve ekonomikë.

AK nuk mund të vendosë kritere me karakter eliminues dhe njëkohësisht të lërë të paqartë kuptimin, njësinë matëse apo mënyrën e dëshmimit të tyre.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pesha totale, pesha bartëse dhe kapaciteti i rezervuarit janë parametra të ndryshëm teknikë dhe nuk mund të trajtohen si të barasvlershëm. Mungesa e përcaktimit të qartë krijon hapësirë për interpretime subjektive dhe zbatim të standardeve të ndryshme gjatë vlerësimit të ofertave.
*Sipas neneve 7, 27 **dhe 28 të LPP-së**, në lidhje me nenet **17 dhe 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik**, AK është i obliguar të hartojë dokumentacion të qartë, të saktë, objektiv dhe jodiskriminues.*
***Kërkojmë nga AK që ta aprovojë si të bazuar këtë pretendim dhe të korrigjojë të gjitha pozicionet e evidentuara në Aneksin 8 përpara vazhdimit të procedurës së prokurimit,** duke përcaktuar qartë peshën totale, operative apo bartëse, si dhe kufijtë minimalë dhe maksimalë,korrigjuar njësitë matëse dhe formulimet kundërthënëse,harmonizuar Aneksin 8 me Aneksin 1 dhe paramasat.*
PRETENDIMI ANKIMOR NR. 5-Vendosja e kërkesave joproporcionale për mekanizim, pa ndërlidhje objektive me paramasën, listën e rrugëve dhe Planin Operativ
Autoriteti Kontraktues, në Aneksin 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, ka përcaktuar një listë të detyrueshme të makinerive, duke imponuar numër, lloj dhe karakteristika të veçanta teknike për secilin LOT, pa paraqitur një arsyetim të mjaftueshëm që dëshmon domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e këtyre kapaciteteve me vëllimin dhe natyrën e shërbimeve të përcaktuara në paramasë.
Në anën tjetër, Aneksi 1, pika 1.1, përcakton se Plani Operativ, përmes të cilit organizohet mekanizimi dhe personeli për secilën rrugë, hartohet dhe dorëzohet 10 ditë pas nënshkrimit të kontratës, për miratim nga organi mbikëqyrës.
Megjithatë, AK ka imponuar paraprakisht disponimin e një strukture të detajuar të mekanizimit si kriter eliminues, pa demonstruar se numri dhe kapaciteti i secilës pajisje burojnë nga një analizë e dokumentuar e sipërfaqeve, gjatësisë dhe kategorive të rrugëve, produktivitetit të makinerive, kohës së reagimit dhe nevojës për intervenime të njëkohshme.
Fakti që AK ka të drejtë të kërkojë kapacitete minimale teknike nuk e përjashton detyrimin që këto kapacitete të jenë të nevojshme, të arsyetuara dhe proporcionale me objektin e kontratës.
Në rastin konkret, përcaktimi i një numri makinerish me konfigurime fikse,mund të përjashtojë operatorë ekonomikë që disponojnë mekanizim funksionalisht ekuivalent dhe kapacitete të mjaftueshme për realizimin e shërbimeve.
Konsiderojmë se kërkesat e tilla, bien ndesh me parimet e ekonomicitetit, konkurrencës dhe trajtimit të barabartë sipas neneve 6 dhe 7 të LPP-së, si dhe me nenet 28 dhe 69 të LPP-së, në lidhje me nenin 19, paragrafët 19.3, 19.4 dhe 19.5 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, që kërkojnë specifikime teknike të qarta, jodiskriminuese dhe që lejojnë përcaktimin e tyre sipas performancës dhe kërkesave funksionale.
Kërkojmë nga AK që ta aprovojë si të bazuar këtë pretendim, te beje korrigjimin e Aneksit 8 në përputhje me parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së lirë.
PRETENDIMI ANKIMOR NR. 6-Vendosja e kërkesave kundërthënëse për dokumentacionin e pajisjeve, duke imponuar librezën e qarkullimit edhe për makineritë që nuk i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm
Autoriteti Kontraktues, në FDT – Kërkesa 5, Dëshmia 5, si dhe në dispozitat e përgjithshme të Aneksit 8, ka përcaktuar se posedimi dhe disponueshmëria e pajisjeve dëshmohen me librezë qarkullimi për automjetet që regjistrohen, ndërsa për pajisjet që nuk regjistrohen pranohen fatura

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

e blerjes, DUD-i ose dokumente të tjera ekuivalente. Për pajisjet që nuk janë në pronësi të OE-së pranohen edhe marrëveshjet e përdorimit apo kontratat e qirasë.
Mirëpo, në LOT VI, pozicionet 10 dhe 11, për ngarkuesin dhe ekskavatorin me rrota, AK ka vendosur kërkesë të veçantë për librezë gjatë fazës së vlerësimit, pa bërë dallimin ndërmjet makinerive që i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm dhe atyre që nuk regjistrohen.
Gjithashtu, në LOT I, pozicioni 2, dhe LOT II, pozicioni 2, kërkohet shprehimisht librezë për fshesat gjatë vlerësimit, ndërsa për fshesat e tjera të së njëjtës kategori funksionale, përkatësisht LOT I, pozicionet 3, 4 dhe 5, si dhe LOT II, pozicionet 3 dhe 10, nuk është vendosur një kusht i tillë i veçantë.
AK nuk ka arsyetuar përse për pajisje të caktuara imponon kushte dokumentare shtesë, ndërsa për pajisje të tjera të ngjashme zbaton vetëm kërkesat e përgjithshme të FDT-së.
Kjo krijon kundërthënie ndërmjet dispozitave të së njëjtës dosje dhe rrezik për trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenet 7, 27 dhe 69 të LPP-së, të cilat kërkojnë trajtim jodiskriminues, dokumentacion të qartë dhe dëshmi të kapaciteteve teknike të lidhura me nevojat e kontratës.
Kërkojmë nga AK që ta aprovojë si të bazuar këtë pretendim dhe të largojë nga Aneksi 8 kërkesën e veçantë për librezë gjatë fazës së vlerësimit në LOT I/2, LOT II/2 dhe LOT VI/10-11, duke zbatuar për këto pajisje të njëjtat kritere dokumentare të përcaktuara në FDT – Kërkesa 5, Dëshmia 5,dokumentacioni për pajisjet duhet të kërkohet sipas detyrimeve ligjore të regjistrimit dhe të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme, pa kushte shtesë selektive që kufizojnë konkurrencën.
PRETENDIMI ANKIMOR NR.7 – Vendosja e kërkesës së panevojshme dhe kufizuese për kamion me kabinë të dyfishtë (double-cabin) dhe peshë bartëse mbi 7 ton
Autoriteti Kontraktues, në Aneksin 8, LOT VI, pozicioni 2, ka kërkuar "Kamion doublekabin pesha mbi 7 ton pesha bartëse", duke imponuar një konfigurim specifik të automjetit.
Theksojmë se kabina e dyfishtë (double-cabin) është karakteristikë e konfigurimit të automjetit, e cila shërben kryesisht për transportin e personelit dhe nuk përcakton kapacitetin apo efikasitetin e transportit të materialeve. Në praktikë, ky konfigurim përdoret gjerësisht te kamionetat, ndërsa kamionët me kapacitet bartës mbi 7 ton mund të realizojnë të njëjtin funksion transporti edhe me kabinë standarde.
Për më tepër, në ***LOT VI, pozicioni 3****, AK ka kërkuar veçmas kamionetë me kabinë të dyfishtë për bartjen e mbeturinave, ndërsa në pozicionin 2 kërkon kamion me të njëjtin konfigurim kabine, por me kapacitet bartës mbi 7 ton.*
Nga përshkrimi i shërbimeve në paramasë nuk rezulton domosdoshmëria e një kamioni me kabinë të dyfishtë dhe peshë bartëse mbi 7 ton, në vend të një kamioni tjetër funksionalisht të përshtatshëm.
Kufizimi i tillë mund të përjashtojë operatorët ekonomikë që disponojnë kamionë me kapacitet të mjaftueshëm bartës, vetëm për shkak të konfigurimit të kabinës, edhe pse automjetet e tyre janë të afta për realizimin e shërbimit.
Konsiderojmë se kjo kërkesë është joproporcionale dhe mund të cenojë parimet e konkurrencës dhe trajtimit të barabartë sipas ***nenit 7 të LPP-së****, si dhe kërkesat për specifikime teknike jodiskriminuese sipas* ***nenit 28 të LPP-së dhe nenit 19 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.***

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kërkojmë nga AK që të largojë nga LOT VI, pozicioni 2, kushtëzimin për kamion me kabinë të dyfishtë (double-cabin) *duke përcaktuar kapacitetet e nevojshme sipas natyrës dhe vëllimit të shërbimeve.*
Kërkojmë që të pranohen kamionë me kabinë standarde për sa kohë që përmbushin kapacitetet funksionale të kërkuara për transportin e materialeve dhe pajisjeve.

Lidhur me pretendimet ankimore, duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese të cilat janë si në vijim:

1. Pretendimi ankimor nr. 1 – Vendosja e specifikimeve teknike kufizuese, të paqarta.
Qëndrimi: PRANOHET PJESËRISHT.
Njësia iniciuese vlerëson se kërkesat për mekanizim janë përcaktuar duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e shërbimeve, karakteristikat e terrenit, kategoritë e rrugëve dhe hapësirave publike, si dhe nevojën për sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme për ndërhyrje në kushte të ndryshme atmosferike.
Kërkesat për pajisje dhe mekanizim synojnë të garantojnë realizimin e shërbimeve në mënyrë të vazhdueshme, përfshirë periudhat me reshje intensive, ndërhyrjet emergjente dhe nevojën për angazhim të njëkohshëm në disa lokacione.
Megjithatë, gjatë shqyrtimit të kërkesave të operatorëve ekonomikë, njësia iniciuese ka identifikuar disa parametra teknikë për të cilët ka propozuar ndryshime, përfshirë përcaktimin e peshës minimale prej 15 ton për ngarkuesin dhe ekskavatorin me rrota në LOT IV dhe LOT VI.
Gjithashtu, janë propozuar ndryshime të parametrave të presionit për pajisjet përkatëse të larjes, siç janë paraqitur në pjesën hyrëse të kësaj përgjigjeje.
Për rrjedhojë, pretendimi pranohet pjesërisht vetëm për parametrat për të cilët është konstatuar nevoja për korrigjim ose harmonizim.
Nuk pranohet pretendimi i përgjithshëm se e gjithë lista e mekanizimit është e panevojshme, kufizuese ose joproporcionale me natyrën e shërbimeve.
2. Pretendimi ankimor nr. 2 – Vendosja e kufijve maksimalë të peshës së pajisjeve
Qëndrimi: NUK PRANOHET.
Njësia iniciuese nuk pajtohet me pretendimin se përdorimi i makinerive me peshë të ndryshme brenda të njëjtit LOT përbën, në vetvete, kundërthënie teknike ose kufizim të pajustifikuar të konkurrencës.
Brenda të njëjtit LOT përfshihen rrugë kryesore, rrugë lokale, trotuare, shtigje biçikletash dhe hapësira të tjera publike me karakteristika të ndryshme.
Pajisjet e kërkuara nuk përdoren domosdoshmërisht në të njëjtat segmente dhe për të njëjtat funksione.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Për shembull, fakti që në një segment rrugor mund të operojë një cisternë me kapacitet të madh nuk nënkupton se një fshesë me peshë të njëjtë ose më të madhe është e përshtatshme për trotuare, shtigje biçikletash apo hapësira me qasje të kufizuar.
Në dokumentacionin teknik të kontrolluar nga njësia iniciuese, në LOT I, pozicioni 5, është përcaktuar fshesë për pastrimin e rrugëve kryesore dhe bulevardeve me peshë totale maksimum 12 ton, ndërsa kufiri maksimum 2 ton i referohet pozicionit 2, për pastrimin e shtigjeve të biçikletave dhe trotuareve.
Këto dy pozicione kanë destinim të ndryshëm përdorimi dhe nuk mund të trajtohen si pajisje me funksion identik.
Për këtë arsye, nuk mbështetet kërkesa e OE-së për largimin e të gjithë kufijve maksimalë të peshës në gjashtë LOT-et.
Kufizimet e peshës duhet të vlerësohen sipas funksionit konkret të pajisjes dhe karakteristikave të hapësirave ku ajo do të përdoret.

3.Përgjigje ndaj pretendimit ankimor nr. 3 – Përcaktimi i presionit të pajisjeve për larjen e rrugëve

Qëndrimi: PRANOHET PJESËRISHT.

Pretendimi pranohet pjesërisht, në pjesën që ka të bëjë me nevojën për saktësimin dhe harmonizimin e formulimit ndërmjet Aneksit 1 dhe Aneksit 8. Nuk pranohet kërkesa për zbatimin e një pragu të njëjtë të presionit për të gjitha pajisjet dhe LOT-et, pasi secili LOT ka specifikat dhe nevojat e veta operative.
Presioni i kërkuar duhet të lidhet me funksionin konkret të pajisjes, llojin e sipërfaqeve dhe natyrën e pastrimit që do të realizohet. Për këtë arsye, pajisjet e përfshira në të njëjtin LOT mund të kenë parametra të ndryshëm, sipas përdorimit të paraparë, me kusht që kërkesat të jenë të qarta, të arsyetuara teknikisht dhe proporcionale me shërbimin.
Gjithashtu, sqarojmë se disa nga kërkesat teknike të referuara në ankesë janë ndryshuar ose saktësuar më herët, në kuadër të përgjigjeve ndaj kërkesave për sqarime të parashtruara edhe nga operatorë të tjerë ekonomikë. Për rrjedhojë, gjatë përgatitjes së ofertave duhet të merren parasysh edhe ndryshimet dhe sqarimet e publikuara në sistemin elektronik të prokurimit.
Për eliminimin e paqartësisë, fjalia e fundit të pikës 3.2 të Aneksit 1, "Presioni i ujit, të cilin e mundëson kamioni për larje të rrugëve, duhet të jetë mbi 50 bar", ta zëvendësojë me tekstin: **"Presioni i ujit për pajisjet e larjes së rrugëve, trotuareve dhe hapësirave të tjera publike përcaktohet veçmas për secilin LOT dhe për secilën pajisje përkatëse, sipas nevojave specifike operative, funksionit të pajisjes dhe natyrës së sipërfaqeve që do të pastrohen".** Vlerat minimale të kërkuara përcaktohen në Aneksin 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm, duke përfshirë ndryshimet e publikuara në sistemin elektronik të prokurimit. Presioni gjatë punës duhet të jetë i kontrollueshëm dhe të përshtatet me sipërfaqen dhe kushtet e operimit, duke shmangur dëmtimin e sipërfaqeve, objekteve përreth dhe rrezikimin e kalimtarëve.

4. Përgjigje ndaj pretendimit ankimor nr. 4 – Paqartësitë në formulimin e kërkesave teknike në Aneksin 8

Qëndrimi: PRANOHET PJESËRISHT.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pas shqyrtimit të pretendimit, pranohet nevoja për saktësimin e formulimeve, njësive matëse dhe mënyrës së dëshmimit të parametrave teknikë, me qëllim që kërkesat të jenë më të qarta për operatorët ekonomikë.
Këto saktësime synojnë interpretimin dhe zbatimin e njëjtë të kërkesave gjatë përgatitjes dhe vlerësimit të ofertave. Kërkesat funksionale dhe kufijtë teknikë mbeten në fuqi, përveç ndryshimeve të përcaktuara shprehimisht në këtë përgjigje.
Të nderuar,
Për eliminimin e paqartësive në formulimin e kërkesave teknike, të bëhen ndryshimet përkatëse në **LOT I, pozicionet 7, 8, 9, 10 dhe 11 të Aneksit 8 - Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe t'i publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas tekstit në vijim:
Pozicioni 7 - Kombi special për pastrimin dhe zhbllokimin e kanalizimit atmosferik
Kombi special për pastrimin dhe zhbllokimin e kanalizimit atmosferik, me **peshë totale të lejuar maksimum 5 ton**, shtypje minimum 120 bar dhe **rezervuar uji me kapacitet minimum 1 000 litra**.
Kapaciteti bartës i lejuar duhet të mundësojë transportimin e së paku 1 000 litrave ujë, së bashku me pajisjet dhe ngarkesat e tjera, pa tejkaluar peshën totale të lejuar të automjetit. Pajisja duhet të ketë gyp për zhbllokimin e kanalizimit atmosferik me gjatësi minimum 50 metra dhe të jetë në gjendje teknike funksionale.
Vërejtje: Kombi gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 8 - Kamioni special për thithje dhe zhbllokim
Kamion special (cisternë), me mekanizëm komplet për thithje dhe zhbllokim, për pastrimin dhe zhbllokimin e ujëmbledhësve dhe kanalizimit atmosferik, me **kapacitet bartës të lejuar mbi 12 ton**.
Sistemi i rezervuarëve duhet të mundësojë ndarjen në **minimum 4 500 litra për thithje dhe minimum 4 500 litra ujë për zhbllokim**.
Pajisja duhet të ketë shtypje minimum 120 bar, gyp për zhbllokim me gjatësi minimum 50 metra dhe gyp për thithje me gjatësi minimum 7 metra. Gjatë përdorimit nuk lejohet tejkalimi i kapacitetit bartës dhe i peshës totale të lejuar të automjetit. Pajisja duhet të jetë në gjendje teknike funksionale.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 9 - Kamioneta speciale për larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike
Kamionetë speciale për larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike, me **peshë totale të lejuar maksimum 3.5 ton, rezervuar uji me kapacitet minimum 400 litra** dhe shtypje minimum 120 bar.
Kapaciteti bartës i lejuar duhet të mundësojë transportimin e së paku 400 litrave ujë, së bashku me pajisjet dhe ngarkesat e tjera, pa tejkaluar peshën totale të lejuar të automjetit. Pajisja duhet të ketë minimum 2 gypa me dizne, secili me gjatësi minimum 50 metra, dhe të jetë në gjendje teknike funksionale.
Vërejtje: Kamioneta gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 10 - Kamioni cisternë për larjen e rrugëve, me kapacitet mbi 6 000 litra

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kamion cisternë ose autobot, me mekanizëm komplet për larjen e rrugëve dhe **rezervuar uji me kapacitet mbi 6 000 litra**, me shtypje minimum 50 bar.
Kapaciteti bartës i lejuar duhet të mundësojë transportimin e sasisë së kërkuar të ujit, së bashku me pajisjet dhe ngarkesat e tjera, pa tejkaluar peshën totale të lejuar të automjetit.
Pajisja duhet të ketë minimum 2 gypa me dizne, secili me gjatësi minimum 5 metra, si dhe sistem larjeje automatike përmes shiritave (shinave) të përparmë. Pajisja duhet të jetë në gjendje teknike funksionale.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 11 – Kamioni cisternë për larjen e rrugëve, me kapacitet mbi 10 000 litra
Kamion cisternë ose autobot, me mekanizëm komplet për larjen e rrugëve dhe **rezervuar uji me kapacitet mbi 10 000 litra**, me shtypje minimum 50 bar.
Kapaciteti bartës i lejuar duhet të mundësojë transportimin e sasisë së kërkuar të ujit, që përfaqëson ngarkesë mbi 10 ton, së bashku me pajisjet dhe ngarkesat e tjera, pa tejkaluar peshën totale të lejuar të automjetit.
Pajisja duhet të ketë minimum 2 gypa me dizne për larje manuale, secili me gjatësi minimum 5 metra, si dhe sistem larjeje automatike përmes shiritave (shinave) të përparmë. Pajisja duhet të jetë në gjendje teknike funksionale.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Dëshmimi i parametrave teknikë
Pesha totale dhe kapaciteti bartës dëshmohen me lejen e qarkullimit (librezën) dhe, kur nevojitet, me dokumentacionin përkatës të homologimit të automjetit.
Kapaciteti dhe ndarja e rezervuarëve dëshmohen me lejen e qarkullimit, kur këto të dhëna janë të shënuara në të, ose me dokumentacion teknik të prodhuesit apo të homologimit për pajisjen konkrete. **Pesha bartëse nuk përdoret si dëshmi e vetme për vëllimin e rezervuarit.**
Kërkojmë që këto formulime të pasqyrohen në mënyrë të njëjtë edhe në pjesët e tjera përkatëse të dosjes së tenderit. Për parametrat që janë ndryshuar më herët përmes sqarimeve të publikuara, të pasqyrohet vlera përfundimtare e publikuar.
Të nderuar,
Për qartësimin e kërkesave teknike, të bëhen ndryshimet në **LOT II, pozicionet 1, 5, 6 dhe 7 të Aneksit 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe t'i publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas formulimeve në vijim:
Pozicioni 1 – Fshesa elektrike me vakum
Fshesë elektrike–thithëse me vakum për pastrimin e rrugëve, me **peshë totale mbi 300 kg**, me buton emergjent, aparat për fikjen e zjarrit të montuar në fshesë, mbushës të baterisë të integruar në makinë, bateri dhe dy pozicione të shpejtësisë së punës.
Pozicioni 5 – Kamioni special për thithje dhe zhbllokim
Kamion special (cisternë), me mekanizëm komplet për thithje dhe zhbllokim, për pastrimin dhe zhbllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik, me **peshë totale të lejuar minimum 3 000 kg (3 ton), sipas lejes së qarkullimit**, dhe shtypje minimum 120 bar.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kapaciteti i rezervuarit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 6 – Kamioni cisternë për larjen e rrugëve
Kamion cisternë ose autobot, me mekanizëm komplet për larjen e rrugëve, me **peshë totale të lejuar maksimum 9 000 kg (9 ton), sipas lejes së qarkullimit**, standard Euro 3 dhe shtypje minimum 15 bar. Gypat duhet të jenë me dizne.
Kapaciteti i rezervuarit të ujit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 7 – Kamioni cisternë për larjen e rrugëve
Kamion cisternë ose autobot, me mekanizëm komplet për larjen e rrugëve, me **peshë totale të lejuar minimum 9 000 kg (9 ton), sipas lejes së qarkullimit**, dhe standard minimum Euro 3. Gypat duhet të jenë me dizne.
Kapaciteti i rezervuarit të ujit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.
Kërkesa për shtypjen të pasqyrohet sipas vlerës përfundimtare të miratuar dhe publikuar në kuadër të trajtimit të pretendimit ankimor nr. 3.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Dëshmimi dhe publikimi
Vlerat e mësipërme i referohen peshës totale të pajisjes ose peshës totale të lejuar të automjetit, jo kapacitetit të rezervuarit dhe as vetëm peshës bartëse. Njësia "litra" zëvendësohet me "kg" ose "ton", sipas formulimeve të përcaktuara më sipër.
Pesha totale e lejuar e automjeteve dëshmohet me lejen e qarkullimit. Për fshesën elektrike të pozicionit 1, pesha totale dëshmohet me dokumentacionin teknik të prodhuesit ose të homologimit dhe, kur është e regjistruar, me lejen e qarkullimit.
Gjatë operimit, pesha e automjetit, së bashku me pajisjet, personelin, ujin dhe ngarkesat e tjera, nuk duhet të tejkalojë peshën totale të lejuar sipas lejes së qarkullimit.
Për qartësimin e kërkesave teknike, kërkojmë të bëhen ndryshimet në **LOT III, pozicionet 1, 4, 7, 8 dhe 12 të Aneksit 8 – Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe t'i publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas formulimeve në vijim:
Pozicioni 1 – Fshesa elektrike me vakum
Fshesë elektrike-thithëse me vakum për pastrimin e rrugëve, me **peshë totale mbi 300 kg**, me buton emergjent, aparat për fikjen e zjarrit të montuar në fshesë, mbushës të baterisë të integruar në makinë, bateri dhe dy pozicione të shpejtësisë së punës.
Vërejtje: Fshesa gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi (librezë).
Pozicioni 4 – Fshesa për pastrimin e rrugëve
Fshesë për pastrimin e rrugëve, me **peshë totale të lejuar minimum 12 ton, sipas lejes së qarkullimit**.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Vërejtje: Fshesa gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi (librezë).

Pozicioni 7 - Kamioni cisternë për larjen e rrugëve

Kamion cisternë ose autobot, me mekanizëm komplet për larjen e rrugëve, me **peshë totale të lejuar maksimum 9 000 kg (9 ton), sipas lejes së qarkullimit**, standard minimum Euro 3 dhe shtypje minimum 120 bar. Gypat duhet të jenë me dizne.

Kapaciteti i rezervuarit të ujit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.

Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).

Pozicioni 8 - Pajisja speciale për larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike

Pajisje speciale për larjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave publike, me **peshë totale të lejuar maksimum 3 500 kg (3.5 ton), sipas lejes së qarkullimit**. Gypat duhet të jenë me dizne dhe gjatësi minimum 30 metra.

Vërejtje: Pajisja gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë e pajisur me leje qarkullimi (librezë).

Pozicioni 12 - Kamioni kiper me kran

Kërkojmë që kërkesën në **LOT III, pozicioni 12**, ta zëvendësojë dhe ta publikojë në sistemin elektronik të prokurimit me formulimin:

"Kamion kiper për pastrimin e borës dhe trotuareve, i pajisur me kran, me peshë totale të lejuar maksimum 1 000 kg (1 ton), sipas lejes së qarkullimit.

Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë)."

Për qartësimin e kërkesës teknike, kërkojmë të bëhet ndryshimi në **LOT IV, pozicioni 9 të Aneksit 8 - Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe ta publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas formulimit në vijim:

Pozicioni 9 - Kamioni special për pastrimin dhe zhbllokimin e kanalizimit

Kamion special (cisternë), me mekanizëm komplet për shtypje dhe zhbllokim, për pastrimin dhe zhbllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik dhe fekal, me **peshë totale të lejuar minimum 6 000 kg (6 ton), sipas lejes së qarkullimit**, dhe shtypje mbi 150 bar.

Kapaciteti i rezervuarit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.

Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).

Të nderuar,

Për qartësimin e kërkesave teknike, kërkojmë të bëhen ndryshimet në **LOT VI, pozicionet 1 dhe 4 të Aneksit 8 - Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe t'i publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas formulimeve në vijim:

Pozicioni 1 - Fshesa elektrike me vakum

Fshesë elektrike-thithëse me vakum për pastrimin e rrugëve, me **peshë totale mbi 300 kg**, me buton emergjent, aparat për fikjen e zjarrit të montuar në fshesë, mbushës të baterisë të integruar në makinë, bateri dhe dy pozicione të shpejtësisë së punës.

Pozicioni 4 - Kamioni special për thithje dhe zhbllokim

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Kamion special (cisternë), me mekanizëm komplet për thithje dhe zhbllokim, për pastrimin dhe zhbllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik dhe fekal, me **peshë totale të lejuar mbi 3 000 kg (3 ton), sipas lejes së qarkullimit**, dhe shtypje mbi 300 bar.
Kapaciteti i rezervuarit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).

7. Saktësimet për LOT VI - Pozicionet 1 dhe 4

Për qartësimin e kërkesave teknike, kërkojmë të bëhen ndryshimet në **LOT VI, pozicionet 1 dhe 4 të Aneksit 8 - Pajisjet dhe Mekanizimi i Obligueshëm**, dhe t'i publikojë në sistemin elektronik të prokurimit, sipas formulimeve në vijim:

Pozicioni 1 - Fshesa elektrike me vakum

Fshesë elektrike-thithëse me vakum për pastrimin e rrugëve, me **peshë totale mbi 300 kg**, me buton emergjent, aparat për fikjen e zjarrit të montuar në fshesë, mbushës të baterisë të integruar në makinë, bateri dhe dy pozicione të shpejtësisë së punës.

Pozicioni 4 - Kamioni special për thithje dhe zhbllokim

Kamion special (cisternë), me mekanizëm komplet për thithje dhe zhbllokim, për pastrimin dhe zhbllokimin e ujëmbledhësve të kanalizimit atmosferik dhe fekal, me **peshë totale të lejuar mbi 3 000 kg (3 ton), sipas lejes së qarkullimit**, dhe shtypje mbi 300 bar.
Kapaciteti i rezervuarit duhet të jetë i përshtatur me kapacitetin bartës të automjetit, në mënyrë që gjatë operimit të mos tejkalohet pesha totale e lejuar.
Vërejtje: Kamioni gjatë fazës së vlerësimit duhet të jetë i pajisur me leje qarkullimi (librezë).

5. Pretendimi ankimor nr. 5 - Vendosja e kërkesave joproporcionale për mekanizim dhe mungesa e ndërlidhjes me Planin Operativ

Qëndrimi: NUK PRANOHET kërkesa për largimin e listës së mekanizimit.

Njësia iniciuese vlerëson se përcaktimi paraprak i kapaciteteve teknike dhe profesionale është i nevojshëm për të siguruar realizimin e shërbimeve të kontraktuara.
Duke marrë parasysh natyrën e mirëmbajtjes dimërore dhe verore, operatorët ekonomikë duhet të disponojnë kapacitete të mjaftueshme për ndërhyrje të vazhdueshme dhe, sipas nevojës, të njëkohshme.
Fakti që Plani Operativ përgatitet pas nënshkrimit të kontratës nuk e përjashton përcaktimin paraprak të kapaciteteve minimale teknike.
Plani Operativ ka për qëllim organizimin e pajisjeve dhe personelit sipas rrugëve, prioriteteve dhe kushteve konkrete të ndërhyrjes, ndërsa kërkesat e tenderit shërbejnë për të siguruar disponueshmërinë e kapaciteteve të nevojshme.
Për këtë arsye, nuk mbështetet kërkesa e OE-së për largimin e strukturës së detyrueshme të mekanizimit.
Njësia iniciuese vlerëson se pajisjet e kërkuara kanë funksione të ndryshme dhe janë përcaktuar duke marrë parasysh karakteristikat e terrenit dhe nevojën për realizimin e shërbimeve në kohë.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Megjithatë, kërkesat individuale për numrin dhe kapacitetin e pajisjeve duhet të jenë të ndërlidhura me nevojat konkrete të kontratës dhe të arsyetuara teknikisht.

6. Pretendimi ankimor nr. 6 – Kërkesat për librezat e qarkullimit të pajisjeve

Qëndrimi: NUK PRANOHET kërkesa për heqjen e përgjithshme të librezave; pranohet harmonizimi i dokumentacionit sipas nevojës.

Njësia iniciuese vlerëson se dokumentacioni i kërkuar për pajisjet duhet të jetë në përputhje me natyrën e tyre dhe detyrimet ligjore për regjistrim.

Për automjetet dhe makineritë që i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm duhet të kërkohet dokumentacioni përkatës i qarkullimit.

Ndërsa për pajisjet që nuk i nënshtrohen regjistrimit të detyrueshëm duhet të pranohen dëshmitë alternative të përcaktuara në FDT, përfshirë faturat, dokumentacionin doganor dhe dokumentet e tjera të vlefshme.

Në dokumentacionin teknik të kontrolluar nga njësia iniciuese, kërkesa për librezë është përcaktuar edhe për fshesat në LOT I, pozicionet 3, 4 dhe 5, si dhe në LOT II, pozicionet 3 dhe 10.

Prandaj, pretendimi i OE-së se këto pozicione nuk përmbajnë kërkesë të veçantë për librezë nuk përputhet me dokumentacionin teknik të kontrolluar.

Njësia iniciuese mbështet harmonizimin e kërkesave dokumentare me FDT-në, duke zbatuar të njëjtat kushte për pajisjet që i nënshtrohen të njëjtit regjim ligjor të regjistrimit.

Për rrjedhojë, nuk pranohet kërkesa për heqjen e përgjithshme të librezave të qarkullimit, ndërsa mbështetet korrigjimi i çdo mospërputhjeje që mund të konstatohet ndërmjet Aneksit 8 dhe FDT-së.

7. Pretendimi ankimor nr. 7 – Kërkesa për kamion me kabinë të dyfishtë (double-cabin)

Qëndrimi: NUK PRANOHET.

Lidhur me pretendimin e OE-së se kërkesa për kamion me kabinë të dyfishtë është kufizuese dhe e panevojshme, njësia iniciuese sqaron se në LOT VI janë përcaktuar dy pozicione të veçanta:

Pozicioni 2: Kamion me kabinë të dyfishtë (double-cabin), me peshë bartëse mbi 7 ton.

Pozicioni 3: Kamionetë me kabinë të dyfishtë (double-cabin), për bartjen e mbeturinave, me peshë bartëse maksimum 2 ton.

Për të dyja pozicionet kërkohet që gjatë fazës së vlerësimit të paraqitet libreza e qarkullimit.

Njësia iniciuese sqaron se kërkesa për këto dy lloje automjetesh është përcaktuar duke marrë parasysh karakteristikat e ndryshme të terrenit, qasjen në rrugë dhe hapësira publike, si dhe natyrën dhe vëllimin e shërbimeve që duhet të realizohen.

Kamioni me peshë bartëse mbi 7 ton është paraparë për transportin e sasive më të mëdha të materialeve dhe mbeturinave, në segmente ku kushtet e terrenit dhe infrastruktura rrugore mundësojnë përdorimin e tij.

Ndërsa kamioneta me peshë bartëse maksimum 2 ton është paraparë për ndërhyrje në rrugë më të ngushta, hapësira me qasje të kufizuar dhe lokacione ku përdorimi i automjeteve me kapacitet më të madh është më pak i përshtatshëm.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Gjithashtu, kërkesa për kabinë të dyfishtë është përcaktuar duke marrë parasysh nevojën operative për transportimin e personelit të angazhuar së bashku me materialet dhe pajisjet e nevojshme për realizimin e shërbimeve në terren.
Për rrjedhojë, këto dy pozicione nuk paraqesin dyfishim të panevojshëm të mekanizimit, por janë përcaktuar për të përmbushur nevoja të ndryshme operative gjatë zbatimit të kontratës.
Njësia iniciuese vlerëson se vetëm fakti që të dy automjetet kërkohen me kabinë të dyfishtë nuk përbën bazë të mjaftueshme për largimin e kësaj karakteristike teknike, përderisa ajo lidhet me organizimin e punës dhe transportimin e personelit në terren.
Përfundimisht, pretendimi ankimor nr. 7 nuk pranohet dhe kërkesat teknike për të dy pozicionet mbeten të pandryshuara.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 13.11.2026

Visar SHEHU

Udhëheqësi i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net